



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr. ____ prot.

Kamëz, më ____ 2018

NJOFTIMI I KONTRATËS

I Autoriteti Kontraktor

Seksioni 1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Bashkia Kamëz
Adresa: Bulevardi "Blu" nr.492, Kamëz, Tiranë
Tel/Fax: +355 47 200 177
Email: bashkiakamez@gmail.com
Faqja e Internetit: www.kamza.gov.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qendror

Institucion i pavarur

Njesi e Qeverisjes Vendore X

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Lloji i Kontratës

Shërbim X

2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

Objekti i kontratës: “PËR DHËNIEN ME KONÇESION TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT, TRANSPORTIMIT, DHE SELEKSIONIMIT TË MBETJEVE TË BASHKISË”

Bashkia e Kamzës në rolin e "**Autoriteti Kontraktor**", fton Operatorët Ekonomik në një procedurë ndërkombëtare Koncesioni/ Partneriteti Publik Privat për dhënie me koncesion të shërbimit të pastrimit, grumbullimit transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve të Bashkisë Kamëz nëpërmjet ndërtimit dhe të një stacioni transferimi në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në këto dokumente tenderi dhe me kushtet e kontratës.

Vlera e parashikuar e projektit është 1 389 833 694 (një miliard e treqind e tetëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH. Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në lidhje me shlyerjen e vlerës së investuar nga koncesionari faktin se koncesionari do të likujdohet për një periudhë kohore prej 12 vitesh nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Koncesionari do të përballojë me të ardhurat e veta të gjithë investimin për makineritë dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit dhe ndërtimit të stacionit të transferimit. Stacioni transferimit duhet të ndërtohen si dhe të jetë funksionale në një afat kohor prej maksimumi 24 (njëzet e katër) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Autoriteti Kontraktor do të paguajë koncesionarit/PPP një shumë të caktuar vjetore. Autoriteti Kontraktor do të zbatojë procedurën e hapur në pajtim me nenin 22 të ligjit nr. 125/2013, i ndryshuar “Për Koncesionet dhe Partneritetit Publik Privat”. Autoriteti kontraktor do të marrë parasysh vetëm ofertat e atyre operatorëve ekonomikë apo Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, të cilët kanë kaluar kufijtë minimalë, të përcaktuara në kriteret e kualifikimit.

Me kryerjen e kësaj procedure, objektivi i Autoritetit Kontraktor është të zgjidhë problemet të cilat janë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve të Bashkisë Kamëz.

Autoriteti Kontraktor do të ofrojë një sipërfaqe për ndërtimin e stacionit të transferimit vendosur përkatësisht: Valias, Kamëz.

Koncesioni/PPP për kontratën është i hapur për operatorët ekonomikë si dhe bashkime të operatorëve Ekonomikë të çdo vendi të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara me poshtë.

1. **Forma e kontratës:** Koncesion/Partneritet Publik Privat
2. **Burimi i financimit:** Bashkia Kamëz
3. **Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

2.3 Kohëzgjatja e kontratës PPP të Koncesionit do të jetë 12 (dymbëdhjetë) vite.

2.4 **Vendndodhja e objektit të kontratës:**

Bashkia Kamëz

Seksioni 3 : Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës nr. 9.

3.2 Sigurimi i Ofertës (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor):

Operatori Ekonomik në një procedure koncesioni/partneritetit publik privat, paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është e barabartë me 2% të vlerës së parashikuar të projektit ose në shumën prej 27 796 674 (njetzet e e shtatë milion e e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

3.3 Në zbatim të pikës 7-të, të VKM-së nr.150, datë 22.03.2007 “Për Organizimin dhe funksionimin e Agjensise se Trajtimit te Konçesioneve”, i ndryshuar me VKM Nr.191, datë 13.03.2012, i cili parashikon, Konçesionari fitues duhet te paguaje per llogari te Agjensise se Trajtimit te Konçesioneve, detyrimin si me poshte vijon:

- a) për projektet koncesionare deri në 5 000 000 (pesë milionë) euro, shuma e pagueshme është 5 000 (pesë mijë) euro.
- b) për projektet koncesionare mbi 5 000 000 (pesë milionë) euro deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 10 000 (dhjetëmijë) euro.
- c) për projektet koncesionare deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milion) euro shuma e pagueshme është 20 000 (njetzetë mijë) euro.
- ç) për projektet koncesionare mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milion) euro shuma e pagueshme është 30 000 (tridhjetë mijë) euro.

Seksioni 4: Procedura

4.1 Lloji i procedurës:

E hapur **X**

E kufizuar

Me negociim
me shpallje
Paraprake

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Nr.	Kriteri	Rezultati Maks.	Pragu Minimal/ Rezultati Kalues
TC1	Projekt-ideja dhe plani i funksionimit dhe menaxhimit të stacionit të transferimit	23	3

TC2	Vlerësimi mbi ndikimin në mjedis dhe ndikimin social	14	2
TC3	Makineritë dhe pajisjet që do përdoren	17	
TC4	Afati ndërtimit të stacionit të transferimit (muaj)	6	
	KRITERET TOTALE TEKNIKE	60	
FC1	Oferta ekonomike	36	
FC2	FEE koncesionare %	4	
	KRITERET TOTALE FINANCIARE	40	
	TOTALI	100	

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data:16/04/2018 Ora 10:00

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data:16/04/2018 Ora 10:00

Vendi: www.app.gov.al

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 300 (treqind) ditë Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip Anglisht

Tjetër _____

Seksioni 5 : Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë:

Po

Jo

Nëse Po

Monedha _____

Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DSK/PPP tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DSK/PPP para blerjes së tyre.

5.2 Vlera e tarifës që duhet të paguhet nga operatori ekonomik në rast të një ankese pranë

Komisionit të Prokurimit Publik eshte sipas tarifave ligjore perkatese.

5.3 Informacione shitesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen eDSK/PPP)

Kujdes: Dokumentacioni i cili do te ngarkohet ne faqen e app-se si (studimi i fizibilitetit, detyrat e projektimit, etj) i cili do ti bashkelidhet dokumentave standarte te koncesionit eshte referues (orientues) per operatoret ekonomike pjesmarres ne proceduren ekonkesionit/PPP.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 01.03.2018

